



Prishtinë, 23 dhjetor 2014  
Kodi i ZRRE-së: V\_676\_2014

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 12.1.20 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 18.11.2014 dhe 17.12.2014 për shqyrtim dhe aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2015 – 2024”

**në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014, nxori këtë:**

## V E N D I M

**I Aprovohet “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2015 – 2024” i KOSTT-it**

## A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18 nëntor 2014 ka pranuar kërkesën për komentim dhe aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2015 – 2024” të KOSTT SH.A. Dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e KOSTT për diskutim publik. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë përfshirë në dokument, janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura.

Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT me datë 17 dhjetor 2014 ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.

ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurtë të sistemit të transmisionit dhe operimin e tregut dhe se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara kështu që aprovon “Planin Zhvillimor të Transmisionit 2015 – 2024”.


**II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.**



- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**




---

Enver Halimi, kryesues



---

Merita Kostari, anëtare



---

Krenar Bujupi, anëtar